ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Korporata Energjetike e Kosovës sha**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **"Zhvarrosja, transporti, arkivoli, varrosja, vendosja e gurëve me mbishkrime"**

Sa i përket tenderit për **KEK – 23-3646-2-2-1.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

V - SH Loti Sh.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

L. Mati 1, blloku C10 – Objekti 02

(Adresa)

Prishtine _____ _____

(Vendi) *(Kodi postar)*

044 379 802 _____ _____

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Bashkim Kameri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

prkosove@gmail.com

(Adresa elektronike)

13.10.2023 _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

TRANSPORT I KUFOMAVE SH.P.K. V-SH LOTI PRISHTINE MORTUARY TRANSPORT

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për kontrate – 18.04.2023
Hapja e ofertave – 02.05.2023
Njoftimi mbi rezultatin ç Aktivitetit 29.09.2023
Kërkesa për ri shqyrtim. 04.10.2023
Vendimi i AK-se, refuzimi i kërkesës 04.10.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Hapja e ofertave – 02.05.2023

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [ ] **Jo** [x]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [ ] **Jo** [ ]

OE V-SH Loti shpk, me datën 04.04.2023, ka parashtruar kërkese për ri shqyrtim te vendimit te AK-se, megjithatë AK, përsëri ka shkelur dispozitat ligjore te ligjit për prokurim publik dhe ka rekomanduar operatorin ekonomik te pa përgjegjshëm.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 28 Specifikimet teknike
Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Neni 54 Njoftimi i Kandidateve dhe Tenderuesve te Eliminuar
Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

OE ankues VSH Loti shpk, bazuar ne dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se, ne afatin parapare me LPP, ka parashtruar kërkesë për ri shqyrtim te vendimit te AK-se, propozimit për dhënie te kontratës, ku eshtë rekomanduar për dhënie te kontratës OE "Eurokod", për aktivitetin e prokurimit me titull: *"Zhvarrosja, transporti, arkivoli, varrosja dhe vendosja e gureve me mbishkrime"* me nr. Te prokurimit KEK-23-3646-2-2-1.

Ne kuptim te nenit 109 te LPP-se paraqesim ketë Ankese:

PRETENDIMET ANKIMORE:

1. AK – KEK sha, me datën 18.04.2023, për ketë procedure te prokurimit ka publikuar njoftimin për informata shtese ose përmirësimin e gabimit dhe ka lejuar përmes kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional qe operatoret ekonomik te prezantojnë dëshmi për realizim te projekteve te ngjashme për periudhën kohore prej 5 viteve:

Kërkesa e AK-se:

1. *Projektet e realizuara brenda 5 viteve te fundit*

Dëshmia dokumentare

1. *"Një liste te aktiviteteve të ngjashme të OE qe specifikon punët e kryera si dhe OE duhet të prezantoje certifikata mbi përfundimin e punëve nga punëdhënësi mbi implementimin e suksesshëm të projekteve për pese vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë me kontaktet për verifikim, me një fushëveprim të ngjashëm të punëve nga ku mund të shihet kapaciteti teknik dhe përvoja e tij"*

Për ketë procedurë te prokurimit edhe paraprakisht ka pasur ankesa ne OSHP ku i njëjti organ përmes vendimeve ka konstatuar se AK – KEK ka shkelur dispozitat ligjore dhe lenden e ka kthyer ne rivlerësim.

AK – KEK përsëri i ka shkelur dispozitat ligjore dhe ka rekomanduar për dhënie te kontratës Operator ekonomik i cili ka prezantuar me oferte te papërgjegjshme.

Pra, bazuar ne kërkesat e kualifikimit dhe gjendjes faktike përkatësisht ofertës se OE te rekomanduar për dhënie te kontratës, AK – KEK ka shkelur dispozitat e nenit 69 paragrafi 4 ku potencohet se për procedura te prokurimit qe kane te bëjnë me sigurim te shërbimeve AK mund te kërkojë nga OE-te qe te sigurojnë te dhënat me te cilat dëshmohet aftësia e tyre profesionale për sigurimin e këtyre shërbimeve.

Ndërsa paragrafi 4.2 i nenit 69 shprehimisht përcakton *qe AK mund te kërkojë listën me te cilën saktësohen te gjitha kontratat kryesore te rëndësishme te shërbimeve te realizuara ne* ***periudhën 3 vjeçare."***

AK përveç se ka shkele dispozitat ligjore ka shkele edhe parimet kryesor duke favorizuar operator ekonomik te papërgjegjshëm, operator ky i cili nuk posedon kurrfarë kualifikimi profesional për natyrën e aktivitetit te prokurimit, nuk i mbulon as kërkesat e përshtatshmërisë dhe provueshmërisë profesionale, nuk posedon kode te veprimtarisë përkatëse te kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne formularin – korrigjimin e gabimit.

Operatori Ekonomik Eurokod Sh.P.K. nuk ka prezantuar ne oferte dëshmi siç eshtë kërkuar – referencën lidhur me projektin e prezantuar ne oferte *"Dislokomi i varrezave nga traseja e Autostradës R6 segmenti C2 dhe C3"* madje kjo kontrate eshtë përfituar kundërligjshëm dhe për ketë çështje kemi Aktgjykim nga Gjykata përkatëse ku eshtë konstatuar një gjë e tille. Neni 65 i LPP-se paragrafi 3 si tërësi e ndalon një gjë te tille. Përkundër këtij fakti, AK Kek Sh.a. për te favorizuar dhe për te lidhe kontrate me OE te caktuar përveç qe ka lejuar dhe mundësuar qe te pranohen kontratat e realizuara përgjatë 5 viteve te fundit, te njëjtit tentojnë ta shpërblejnë me kontrate operatorin ekonomik i cili përmes procesit gjyqësor eshtë argumentuar se ka realizuar kontrate te kundërligjshme.

Ne ueb faqen e KGJK-se mund ta gjeni Aktgjykimin e Gjykatës përkatëse për projektin përkatës.

Për me tepër, pikërisht për ketë projekt qe AK nuk e ka argumentuar me certifikate – referencë, pasiqë një gjë eshtë e pamundur dhe kjo referencë nuk ekziston për ketë projekt, mund t'i referoheni vegzave te mëposhtme për te konfirmuar gjendjen reale.

Projektet tjera te prezantuara ne oferte asnjëra nga to nuk kane kurrfarë lidhje me punët te ngjashme dhe me objektin e kontratës, te gjitha projektet e prezantuara kane te bëjnë me ndërtim dhe jo me shërbime te tilla.

https://paparaci.com/149486/buxheti-u-demtua-mbi-770-mije-euro-deklarohet-i-akuzuari/

https://betimiperdrejtesi.com/deshmitarja-thote-se-kompania-e-saj-nuk-ka-kryer-asnje-sherbim-lidhur-me-tenderin-per-dislokim-te-varrezave-ne-kacanik/

Për qeshje te projekteve kundërligjore, projekte te nënkontraktuar dhe kontrata te lidhura kundërligjshëm ekzistojnë me dhjetar vendime te KRPP-se, OSHP-se dhe organeve tjera ku operatoret ekonomik te cilet kane përfituar kundërligjshëm jo qe duhet te eliminohen nga procedura e prokurimit por te njëjtit ne kuptim te nenit 99 te LPP-se duhet te përjashtohen për periudhe te caktuar nga pjesëmarrja ne procedura te prokurimit.

Kontrata dhe raporti i pranimit te punëve sipas linqeve te lartë përshkruara dhe Aktgjykimeve te Gjykatës kompetente përshkruhet se kemi te bëjmë me kontrate jo kornizë dhe e njëjta kontrate eshtë e lidhur me datën 19/07/2016 e rrjedhimisht e njëjta ka pasur sasi te identifikuar dhe periudhe te realizimit jo me shume se 1 vit. Prandaj, AK detyrimisht ka qene dashur ta eliminoje ofertën e OE Eurokod Sh.P.K.

2. Ne si OE edhe përmes kërkesës për rishqyrtim kemi kërkuar qe te behet rishqyrtimi ofertave dhe te aplikohen ne tërësi dispozitat ligjore mirëpo AK nuk e ka bere një gjë te tille, prandaj ne si OE kërkojmë qe OSHP – paneli shqyrtues dhe eksperti shqyrtues qe ta obligoje AK – KEK SH.A. qe përmes procesit te rivlerësimit te ofertave te kërkojë sqarime shtese nga OE Eurokod përkatësisht nga Ministria e Infrastrukturës qe te prezantohet njoftimi për kontrate apo edhe kushtet e veçanta te kësaj kontrate ne atë mënyrë qe te verifikohet kohëzgjatja e kësaj kontrate. Sipas Aktgjykimit te Gjykatës përkatëse dhe linqeve rezulton qe kjo kontrate eshtë e lidhur kundërligjshëm dhe AK detyrimisht nuk duhet ta pranoje si te mirëqenë bazuar ne dispozitat e nenit 65 dhe 69 te LPP-se.

Prove: Njoftimi për kontrate – dosja e tenderit te kërkohet tek AK – MI ne mënyrë qe te verifikohet periudha e kontratës dhe te verifikohet nëse ekziston referenca.

3. OE ankues përmes kërkesës për rishqyrtim e ka sqaruar se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk posedon kod veprimtarie dhe si operator ekonomik nuk ka kurrfarë përvojë eksperience lidhur me natyrën e kësaj procedure te prokurimit. Sipas vendimit te AK-se – refuzimit te kërkesës sonë te datës 04/10/2023 AK - KEK Sh.A ketë çështje e trajton si devijim te vogël i cili nuk ndikon ne ndryshim material. AK ka qëllime te caktuara për t'a lidhur një kontrate te kundërligjshme me OE dhe për ta favorizuar te njëjtin përkundër faktit se ekzistojnë prova shkresore dhe baza ligjore për t'a eliminuar te njëjtin, për me tepër, kjo çështje konfirmohet edhe sipas njoftimit te fundit mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit ku AK – KEK Sh.A fare nuk nxjerre letër standarde dhe nuk jep arsye te eliminimit per operatoret ekonomik pjesëmarrës ne ketë procedure te prokurimit përfshirë edhe ofertën tone. Kjo çështje – ky veprim paraqet shkelje te nenit 54 paragrafi 1, pika 1.1 te LPP-se ku potencohet:

1.1.në rast të eliminimit të kandidatit, njoftimi do të shpjegojë arsyet për refuzimin e kërkesës për pjesëmarrje të atij kandidati.

1.2.në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë.

AK - KEK Sh.A. nuk ka dhënë kurrfarë arsye te eliminimit lidhur me ofertat e radhitura me poshtë për nga çmimi. Rrjedhimisht as kundrejt ofertës tone nuk ka nxjerre letër standarde si tenderues i pasuksesshëm, meqë neve si OE kemi dorëzuar oferte e cila i plotëson te gjitha kërkesat kualifikuese te përcaktuara ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontrate.

Bazuar ne faktet, provat dhe dëshmitë e prezantuara me larte dhe atyre te bashkangjitura ne oferte, kërkojmë qe OSHP – Paneli Shqyrtues qe te nxjerr ketë:

VENDIM

Te aprovohet, Ankesa jone ne tërësi si e bazuar ,
Te anulon, propozimi për dhënie te kontratës dhe ,
Lënda te kthehet ne Rivlerësim tek AK dhe te behet vlerësim real i ofertave bazuar ne kërkesa kualifikuese dëshmi dhe dispozita ligjore dhe te korrigjohen shkeljet e ligjit.

Shkelja e parimeve ne prokurim publik, favorizimi i OE-ve te caktuar, krijimi i kërkesave kufizuese dhe favorizuese për operator ekonomik te caktuar, vlerësimi jo real i ofertave dhe veprimet tjera kundërligjore te faktuara si me larte konsiderohen si shkelje te renda dhe janë te sanksionuara me nenin 97 te RRPP-se nr. 001/2023.

Prandaj ne si kompani kërkojmë qe eksperti shqyrtues ne kuptim te dispozitave ligjore si tërësi dhe nenit 113, te LPP-se ne veçanti ti trajtoj pretendimet tona ne mënyrë reale, te kërkoj sqarim ti verifikoi dëshmitë e prezantuara nga OE i rekomanduar për dhënie siç eshtë projekti i Dislokimit te varrezave ne Trasenë e Autostradës R6, ose te obligohet AK – KEK qe përmes rivlerësimit te kërkoj sqarim për ketë projekt dhe te verifikohet periudha kohore dhe referenca, meqë ky projekt me vendim gjyqësor eshtë konstatuar si kontratë e kundërligjshme.

P.S, për ketë procedurë te prokurimit edhe paraprakisht janë nxjerre vendimi nga OSHP- Paneli Shqyrtues dhe AK – KEK, i interpreton ne atë mënyrë qe te favorizoi operatorin ekonomik te rekomanduar për dhënie.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*